

NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë


E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Arkivat e Vatikanit për kishat katolike të shqiptarëve në Kosovë, shek II-XVII

Rrënimi dhe përvetësimi i kishave katolike nga serbët

Dossier nga Dr. Jahja Drançolli

faqe 14




Mbi Petro Markon dhe familjen tij në nevojë

Arianita gati po qante me dënësë...

Esse nga Gëzim Zilja

faqe 19



EDITORIAL

Ballkani dhe konferenca e Sarajevës

Esse nga Skënder Buçpapaj



Në një studim ndëryjor nga më të fundit, nisur nga të dhëna të nxjerra prej teleskopëve në

yllësinë e Udhës së Qumështit, përshkruhej një dukuri e panjohur më parë: satelitët përpijnë planetet e tyre. Ky zbulim fare i freskët shkencor nuk mund të mos e shoqëronte përfytyrimin për raportet mes Ballkanit dhe Evropës në kontekstin e një takimi të organizuar në Sarajevë nga Bashkimi Evropian me vendet e Ballkanit

Vijon në faqen 20

Para nga qielli...!

Esse nga Nazmi Lukaj



Pas luftës, në Kosovë kanë grumbulluar pasuri vetëm disa nga firmat e mëdha. Janë nja dhjetë sosh që e kontrollojnë krejt biznesin. Mjaft bi-

znismenë që dikur kanë qenë përafërisht me pasuri me këta të sotmit, ose kanë falimentuar, ose janë në falimentim e sipër. Disa biznismenë kanë mbetur duke e zhiluar veprimtarinë jashtë Kosovës...

Faqe 20

"Nacional" publikon, "Protonizmi: Nga teoria në praktikë, vizione letrare", të Gjekë Marinaj

"Gjekë Marinaj shpik Protonizmin"

faqe 3



"Miss Kosova" Kështjella Pepshi, pretendente për "Miss Univers 2010"

Faqe 12

Në BRENDËSI

Shpërthimi i fshehtë...

Studim nga Skënder Drini

faqe 5

Lasgushi dhe redaktorët

Kujtime nga Naum Prifti

faqe 7

Nobelisti Rudi Kipling

Studim nga Egla Kokalari

faqe 11

Lindja e shtetit të Kosovës

Dossier nga Prof. Sali Kelmendi

faqe 8

Semiotika në pikturën e Lin Delisë

Esse nga Qamil Gjyzezi

faqe 16

Pavana

Prozë nga nobelisti Le Klezio

faqe 10

"Sekreti i varrit të vetmuar"

Roman nga Rreshat Kripa

faqe 21

Tregime nga: Bahri Myftari, Izet Shehu

faqe 17

Poezi nga: Sazan Goliku, Millanov Kallupi, Petraq Kote, Davila Hasandoçi, Kadrush Radogoshi, Valbona Hyka, Rustem Geci

faqe 6-19



Albanian Refining & Marketing of Oil

PËR HERË TË PARË
EURODIESEL
I STANDARTEVE EUROPIANE

PCALBANIA
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art

“Nacional” publikon: “ Protonizmi: Nga teoria në praktikë, vizione letrare”, të Gjekë Marinaj

Marinaj shpik “Protonizmin”

“Marinaj, pedagog i gjuhës dhe komunikimeve Angleze dhe i lëndës së Letërsisë Botërore në Richland College në Dallas SHBA, ka bazuar kërkimet e tij letrare mbi letërsinë bashkëkohore botërore mbi një teori të re të quajtur prej tij “Protonizmi”, term i pranuar si një risi në kritikën botërore, edhe nga shkolla amerikane e letërsisë dhe arteve.”

Shtepia botuese “Nacional” publikoi këto ditë librin më të ri të poetit, studjuesit dhe përkthyesit të mirënjohur Gjekë Marinaj “Protonizmi: Nga teoria në praktikë, vizione letrare.”

Marinaj, pedagog i gjuhës dhe komunikimeve Angleze dhe i lëndës së Letërsisë Botërore në Richland College në Dallas SHBA, ka bazuar kërkimet e tij letrare mbi letërsinë bashkëkohore botërore mbi një teori të re të quajtur prej tij “Protonizmi”, term i pranuar si një risi në kritikën botërore, edhe nga shkolla amerikane e letërsisë dhe arteve.

Siç thotë edhe vetë autori “Protonizmi është një teori e re letrare si për letërsinë shqipe ashtu edhe për atë botërore. Si perceptim linguistik e përshtatje terminologjike është bazuar në linjat shkencore të kimisë dhe fizikës, më saktë në

fjalën *Proton* që si pjesë përbërëse e bërthamës së atomit ka ngarkesë elektrike pozitive +1. Protonizëm, në kuptimin më të thjeshtë, do të thotë të shkruash rreth një vepre letrare apo artistike me qëllim pozitiv, i shtyrë nga dashamirësia jo nga vleri.”

“Protonizimi”, shënon një standart të ri të kritikës shqiptare, jo vetëm për nga niveli i lartë dhe plot dije i trajtimit akademik të veçorive të letërsisë bashkëkohore, por edhe vizioneve letrare për të ardhmen. Pikërisht kjo pikë e mendimit e ndanë Protonizmin si vizion letrar nga arti tradicional i kritikës letrare e artistike.

Libri është i ndarë në 11 kapituj. Konkretisht: prozë, poezi, antologji, mitologji dhe legjenda, monografi, gazetari, pikturë dhe fotografi, shkencë dhe sociologji, muzikë, portrete,

kritikë. Libri ka rreth 400 faqe. Pjesa më e madhe e shkrimeve janë botuar në shtypin letrar amerikan, ndërsa një pjesë e tyre në gazetën “Nacional.”

Në një periudhë kur letrat shqipe e ndjejnë mungesën e një kritike profesioniste dhe të kualifikuar, shtepia botuese “Nacional” me botimin e këtij libri plotëson një boshllëk të madh në këtë fushë.

Libri do t’u shërbejë posaçërisht studentëve, pedagogve dhe studiuesve të letërsisë bashkëkohore të cilët do të kenë informacionet më të qarta kryesisht për letërsinë bashkëkohore amerikane. Sic thotë vetë autori Gjekë Marinaj, “Shpresoj që duke ofruar Protonizmin si një alternative të re për trajtimin letrar, do të vëmë re se mënjanimi i negatives merr kahe pozitive në

rolin estetik, në subjektivizmin dhe objektivizmin e observimit të realitetit, si dhe në molimfeshin e shumëfishtë të humanizmit. Përqendrimi im akademik ka si epiqendër përpjekjen për t’i dhënë jetë këtij tabani të ri teorik. Një lëvizje e tillë, natyrisht, duhet të mbështetet në njëfarë filozofie të para-supozuar, dhe zbulimet e bëra duhet të tërheqin pas vete implikimet metafizike dhe epistemologjike që mbart në vetvete Protonizmi.”



Në foto: Gjekë Marinaj

Protonizmin si një alternative të re për trajtimin letrar

PROTONIZMI SI VIZION LETRAR

“Protonizmi si perceptim linguistik e përshtatje terminologjike është bazuar në linjat shkencore të kimisë dhe fizikës, më saktë në fjalën *Proton* që si pjesë përbërëse e bërthamës së atomit ka ngarkesë elektrike pozitive +1. Protonizëm, në kuptimin më të thjeshtë, do të thotë të shkruash rreth një vepre letrare apo artistike me qëllim pozitiv, i shtyrë nga dashamirësia jo nga vleri.”

Nga Gjekë Marinaj

Protonizmi është një teori e re letrare si për letërsinë shqipe ashtu edhe për atë botërore. Si perceptim linguistik e përshtatje terminologjike është bazuar në linjat shkencore të kimisë dhe fizikës, më saktë në fjalën *Proton* që si pjesë përbërëse e bërthamës së atomit ka ngarkesë elektrike pozitive +1. Protonizëm, në kuptimin më të thjeshtë, do të thotë të shkruash rreth një vepre letrare apo artistike me qëllim pozitiv, i shtyrë nga dashamirësia jo nga vleri. Në nivele më të thella letrare, natyrisht, Protonizmi është interpretimi i hipotezës të së njohurës në kuptimin metafizik dhe i të njohurës jo deri në fund në kuptimin filozofik. Ai është pjesë esenciale e parametrave të etikës, dhe shërben si orientim që i besojmë tek ndërmarrim udhëtime instinktive apo të menduara drejt sferave të së vërtetës objektive në letërsi dhe art.


Pikërisht kjo pikë e mendimit e ndanë Protonizmin si vizion letrar nga arti tradicional i kritikës letrare e artistike. Protonizmi është degë e arteve dhe humanizmit, jo patjetër degë e shkencës mbi letërsinë dhe artin. Ndonëse të dyja merren seriozisht me analizimin e gjithanshëm të veprave letrare e artistike, kritika letrare e traditës tenton ta analizojë dhe ta vlerësojë letërsinë e artin nisur nga ana ideore në bazë të parimeve të miratuara nga një ideologji e caktuar në një kohë të caktuar, duke u përqendruar si në anët pozitive ashtu edhe në ato negative të një vepre. Protonizmi, në kontrast, është gjithmonë në ekuilibër jo me ideologjitë politike, por me kërkesat ideore e artistike të kohës, duke mos u ndalur fare tek mangësitë për t’u përqendruar plotësisht

vetëm në analizimin dhe nxjerrjen në pah të anëve pozitive dhe të së bukurës në letërsinë dhe artin që trajton.

Shpresoj që duke ofruar Protonizmin si një alternative të re për trajtimin letrar, do të vëmë re se mënjanimi i negatives merr kahe pozitive në rolin estetik, në subjektivizmin dhe objektivizmin e observimit të realitetit, si dhe në molimfeshin e shumëfishtë të humanizmit. Përqendrimi im akademik ka si epiqendër përpjekjen për t’i dhënë jetë këtij tabani të ri teorik. Një lëvizje e tillë, natyrisht, duhet të mbështetet në njëfarë filozofie të para-supozuar, dhe zbulimet e bëra duhet të tërheqin pas vete implikimet metafizike dhe epistemologjike që mbart në vetvete Protonizmi.

GJЕКЭ MARINAJ (BIOGRAFIA)

Gjekë Marinaj (1965) u lind në Brrut të Malësisë së Madhe. Ka botuar disa libra me poezi, prozë dhe përkthime. Në vitin 2001 ka mbaruar Fakultetin e Shkencave të Përgjithshme (Associate in Science) në Brookhaven College. Katër vjet më vonë, mbaroi Shkollën e Arteve dhe Humanizmit (Bachelor of Arts in Literary Studies: Magna Cum Laude) në Universitetin e Teksasit në Dallas. Shkollën e Arteve dhe Humanizmit (Master of Arts in Humanities—Studies in Literature) e mbaroi në vitin 2008 në UT Dallas. Aktualisht vazhdon Doktoraturën: ku është Kandidat për Ph.D (Doktor i Filozofisë) po në Universitetin e Teksasit në



Dallas. Në vitin 2003 është nderuar me Çmimin Pena e Artë nga SHSHSHA. Çmimin e Parë në poezi, akorduar nga revista letrare amerikane Sojourn, e pranoi në vitin 2006. QNK (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës) e nderoi

me çmimin Pjetër Arbnori në Letërsi në vitin 2008. Marinaj është pedagog i gjuhës dhe komunikimeve Angleze dhe i lëndës së Letërsisë Botërore në Richland College në Dallas të Tek-